**“Kur jeni të kërcënuar nga ankthet e fatkeqësisë, frikës e tronditjes, hyni në kopshtin e mirësisë dhe angazhohuni me të tjerët, duke u dhënë, ndihmuar e shërbyer, do të gjeni  lumturinë me shije, ngjyrë e prekje.”**

**A. el K. “Mos u trishto”**

# KOPSHTI
# I MIRËSIS

botuesi:

Autor:
Xhemajl Sheremti

Lektura & redaktura
Emine Sertolli

Renditja kompjuterike & ballina
Granit SHeremeti

## KOPSHTI I MIRËSISË – në vend të parathënies

Vitet 1998/99 ishin plot me kërcënime, tronditje dhe fatkeqësi për popullin e Kosovës. Serbia e pangopur me gjakun e dhjeta mijëra njerëzve nga Kroacia dhe Bosnja, si një kuçedër e çartur, u vërsul mbi popullin e Kosovës duke vrarë, duke masakruar, duke plaçkitur, duke djegur e duke shkatërruar çdo gjë që frymonte shqip apo ishte shqiptare. Shumë familje shqiptare i shkatërroi fare. Disa familje i la në femra. Disa të tjera i la pa shtëpi e pasuri. Shumë fëmijë i la jetimë. Duke mos u ngopur me tërë këto krime, shumë viktima i la edhe pa varre, i zhvarrosi dhe i barti në Serbi!!! Më shumë se një milion shqiptarë i përzuri me dhunë nga Kosova. Shqiptarët, të gjendur përballë këtij fati të keq u angazhuan për t`i ndihmuar dhe shërbyer njëri-tjetrit.
Ky libër dokumentar është përmbledhje e disa faksimileve dhe fotografive nga dokumentet e krijuara dhe të ruajtura nga familja ime, në Shkallnur të Durrësit, gjatë trajtimit të refugjatëve, në periudhën kohore qershor 1998-qershor 1999.
Publikimi i një pjese nga mijëra faqe dokumentesh të tilla bëhet me qëllim që:
- T`u shprehet mirënjohje të gjithë atyre njerëzve që u vunë në shërbim të refugjatëve, duke i lehtësuar  dhimbjet e tyre.
- T`u përkujtohen njerëzve të Kosovës ditët e vështira të eksodit, që t`i përdorin më mirë mundësitë e dhëna nga liria dhe pavarësia, për të rregulluar jetën në Kosovë, duke lënë anash motivet e ulëta dhe dobitë personale, për efekte të interesit të përbashkët.
- Të sinjalizohen kureshtarët, se ekzistojnë mijëra faqe me dokumente të tilla në të cilat mund të bëhen studime të dobishme.
- Të motivohen qeveritarët, nga Kosova dhe nga Shqipëria, që duke bërë ndonjë monument meritor, të shtojnë edhe një urëlidhëse ndërmjet qytetarëve të tyre.

Renditja e faksimileve dhe e fotografive është bërë në atë mënyrë që të kenë lidhje përmbajtësore, pavarësisht nga koha e bërjes së tyre.
Shkrimet e tjera mundësojnë që lexuesi të krijojë pasqyrë më të qartë për shkaqet dhe rrethanat që e bënë Shkallnurin të njihet si qendra më interesante e refugjatëve.



Shtëpia e familjes Sheremeti në Pejë
e djegur nga ushtarët serbë më 27.3.1999.



## Pranvera e vitit 1998 në Kosovë

Pranverë i patëm thënë por u nxi nga krimet e forcave serbe. Në fillim ndodhën Qerezi, Likoshani, Prekazi e Lubeniqi. Pastaj e tërë Kosova u shndërrua në ferr. U boshatisën fshatrat duke u granatuar, plaçkitur e djegur nga militarët serbë, me fytyra të çoroditura me lloj-lloj ngjyrash e vizatimesh, si lugetërit, që ishin mësuar me gjak njeriu në Bosnje e Kroaci.

Qytetet u stërmbushën me gra, fëmijë e të moshuar. Në autobusët e rrallë që lëviznin ndërmjet qyteteve mund të shihje vetëm gra me fytyra të zymta dhe me ndonjë fëmijë përdore, burrat sikur t`i kishte përbirë toka.

Trimat i nxorën armët e fshehura nga baballarët e tyre dhe morën malet. Shumë të tjerë të punësuar nëpër botë u kthyen dhe u bashkuan me ta. Bllokuan rrugët kryesore Pejë-Prishtinë dhe Pejë-Gjakovë, për të vështirësuar sadopak lëvizjen e focave serbe. Nga ana tjetër ata i hapën rrugët malore për furnizime me armë, ushqime dhe për lëvizjen e popullatës së përndjekur. Për të udhëtuar me autobus nga Peja në Prishtinë ishte e hapur vetëm rruga Pejë-Rozhajë-Mitrovicë-Prishtinë. Krismat shurdhuese të granatimeve nga Zagerma e Pejës, nga Podi i Gështenjave dhe nga Suka e Hereqit u kishin futur tmerrin edhe qenëve endacakë, të cilët në lukuni të mëdha vërshonin rrugët dhe lulishtet e qytetit, pasi që ishin ushqyer mirë me kafshët e vrara nëpër kullosat përreth. Njerëzit rrinin të mbyllur nëpër shtëpitë e qytetit duke përcjellë lajmet, dilnin vetëm në raste emergjente. Ata që i kishin shtëpitë buzë rrugës që çonte në varrezat e serbëve kishin rastin të shihnin kortezhe mortore të përcjella nga bandat muzikore të ushtrisë serbe, shenjë kjo që dëshmonte se djemve tanë nuk u kishin shkuar predhat kot.

Ethet e luftës shtoheshin gjithnjë e më shumë, jetës i kishte rënë çmimi. Megjithatë mësimi vazhdonte nëpër shtëpitë-shkolla, por numri i nxënësve dhe i mësimdhënësve zvogëlohej nga dita në ditë, shumë familje kërkonin strehim jashtë Kosovës.

Ofensivat e mëdha të forcave serbe që pasuan, me metodat e tokës së djegur, e detyruan popullin në shpërngulje masive përtej bjeshkëve. U boshatisën në fillim fshatrat e Rekës së Keqe e të Dushkajës. Deri në vjeshtë, vetëm në Shkallnur të Durrësit, numri i refugjatëve arriti më shumë se katër mijë. Dhjetë mijë të tjerë u shtuan pas bombardimeve nga NATO.

Tmerreve të shkaktuara nga forcat serbe u shtoheshin ato ditë edhe dhimbjet e përçarjes ndërmjet forcave kosovare, me të cilat populli i kishte lidhur shpresat për fitore. Populli edhe në ato rrethana doli masivisht nëpër rrugët e qyteteve duke brohoritur për Rugovën, për UÇK-në dhe për Republikën e Kosovës.

Konferenca në Rambuje dhe bombardimet e NATO-s i dhanë kurajo popullit të Kosovës t`i përballojë edhe dhimbjet shumë më të mëdha që pasuan. Atë botë Kosova po boshatisej me dhunë nga të gjallët, e nga ana tjetër forcat serbe ishin lëshur si hienat mbi varrezat e viktimave, duke i zhvarrosur ata dhe duke i transportuar në Serbi. Kush mund ta dijë se për çfarë u duheshin edhe ato krime?!



Bombat e NATO-s e shkatërruan bazën elektronike informative ushtarake serbe, pranë shtëpisë së familjes Sheremeti në Pejë.



Ushtarët serbë i djegën dyqanet e familjeve Sheremeti dhe Kasapi në Pejë.

**Dokumentet e ruajtura në Shkallnur:**

a) Regjistri i të ardhurave (nga kanë ardhur, ku janë strehuar) në periudhën kohore (1.6.1998 – 3.8.1999) për 14470 persona.
b) Regjistri i dhënësve të ndihmave dhe disa dëshmi të dhënies.
1) Familja Sheremeti nga Peja, e cila ofroi pritje dhe përkujdesje si dhe bëri regjistrimin refugjatëve;
2) Nazif Tivari nga Durrësi;
3) Mehmet Xhemail Hoti nga Ulqini;
4) Kozara Kati nga Tirana;
5) Adrian Kati nga Tirana;
6) Selim Berisha;
7) Anesti Dimiter;
8) Martin Cukala, Prefekti i Durrësit;
9) Fatmir Mujaj;
10) Ish-deputeti i Durrësit;
11) Mehmet Hoxha (Domanek) dhe Akif Beqiri (Likoshan) nga Zvicra;
12) Refki dhe Hamide Bytyqi (nga Suhareka) nga Hanoveri i Gjermanisë;
13) Kujtime dhe Ramiz Halimi nga Digolfingu i Gjermanisë;
14) Musa Tolaj (Pobergj) nga Gjermania;
15) Malë Hoti (Kliçinë) nga Amerika;
16) Kadri Dreshaj (Pejë), Ilir Trakaj, Adem Tahiri, Sali Mehmeti nga Finlanda;
17) Musa Blaka, Tahir Blaka, Ramiz Kaliqani (Pejë), Nosh Noshi (Gjakovë), Shefqet Tolaj (Voksh), Mustafë Logja (Pejë), Maliq Vraniqi (Prizren);
18) Kryqi i Kuq Shqiptar;
19) Shoqata "Kosova" (Miftar Gjonbala, Xhemajl Avdyli);
20) Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – Tiranë;
21) Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut – Tiranë;
22) Kryqi i Kuq Ndërkombëtar – Gjenevë (Graziella);
23) Kisha Katolike Viençenciane;
24) LDK e Grave – Durrës (Majlinda...);
25) Merey Internacional USA – Zyra në Tiranë (Abone Binaj, Fatmir Tare, Tajar Bonjaku);
26) CRS (Catholic Relief Services) (Sieglinde Gass/man) (Abens Ahite);
27) Karitasi holandez (Anila Mjeda);
28) Kisha Protestante – Gjermani (Manfred Kyle);
29) Shoqatat "Nëna Terezë" (Frankfurt) dhe "Njerëzit në Fatkeqësi" (Miltenburg);
30) Shaban Berisha;
31) Shoqata "El Hilall" – Tetovë ( Xhafer Xhaferi, Surja Imami, Elez Ismaili);
32) Kisha Katolike e Durrësit (Damjan Kurti);
33) Qeveria e Republikës së Kosovës – Zyra në Tiranë (Musa Rexha);
34) Xhamia e Durrësit (Besim Braha, Rifat Tafili, Rexhep Voçari);

35) Shoqata "Në dobi të grave shqiptare" (Sevim Arbana, Fabiolla Egro);
36) IRC (International Rescue Committee);
37) Holanda (Dynek);
38) Ramadan Gashi nga Peja me qëndrim në Amerikë (lidhjen telefonike);
39) Osman Krasniqi nga Juniku, me punë në Zvicër (Fiat uno për Shtabin);
40) Familjet e tjera vendore që ofruan strehim falas (mijëra sish);

Llojet e ndihmave:

1. Pako ushqimore e higjienike për foshnje e të rritur;
2. Veshmbathje për fëmijë e të rritur;
3. Dyshekë, çarçafë e batanije për shtretër;
4. Mjete kuzhine për përgatitje të ushqimit: furnela me gaz, enë, pjata etj.;
5. Materiale ndërtimi për rregullimin e dhomave për banim;
6. Medikamente për shërimin e të sëmurëve;
7. Asistencë transporti për të sëmurët deri në qendrat mjekësore;
8. Karroca për invalidë;
9. Vizita mjekësore në ambulancë dhe nëpër familje;
10. Libra dhe mjete mësimore për nxënës të shkollave fillore e të mesme;
11. Shkolla argëtuese për fëmijët parashkollorë dhe të klasave të ulëta;
12. Aktivitete kulturore e sportive për fëmijë më të rritur;
13. Trajnime për asistencë psiko-sociale për mësimdhënësit, mjekët dhe intelektualët e tjerë, duke u paguar edhe mëditje;
14. Kurse për gjuhët e huaja dhe për kompjuterë;
15. Mjete dhe materiale për punë artizanale për femrat;
16. Ekskursione për fëmijë e të rritur;
17. Informacione për gjetjen dhe bashkimin e familjeve të ndara;
18. Pagesa mujore për mjekët, ndihmësmjekët dhe pedagogët e shkollave argëtuese;
19. Bukë të gatuar, vaj ushqimi, perime të freskëta e të konservuara për përgatitjen e ushqimeve të ngrohta etj.

Shërbimet e ofruara nga Shtabi i Shkallnurit

1. Përgatitja dhe mirëmbajtja e ambienteve për pranimin e refugjatëve, për pranimin e mallit për refugjatë, për ambulancën e refugjatëve dhe për shkollën argëtuese.
2. Sistemimi i refugjatëve në vendet e caktuara për strehim dhe regjistrimi i tyre duke evidentuar adresat e mëparshme, adresat ku janë sistemuar, moshën dhe gjininë.
3. Evidentimin e nevojave materiale, shëndetësore dhe psiko-sociale për të ardhurit si dhe asistencën për përmbushjen e nevojave përkatëse.
4. Mbajtja e kontakteve me pushtetin vendor, me shoqatat humanitare, me

donatorët vendorë e ndërkombëtarë për të siguruar furnizimet e nevojshme për refugjatët, duke i furnizuar ato me informacione e statistika të nevojshme.

5. Mobilizimi i aktivistëve nga radhët e refugjatëve dhe vendorëve, për të përballuar situatat e ndryshme emergjente që krijoheshin nga fluksi i madh i të ardhurve.

6. Përkujdesja për trajtim dinjitoz të secilës familje dhe të secilit person të nevojshëm për çfarëdo lloj ndihme.

7. Pritja dhe informimi i saktë i delegacioneve të jashtme dhe përfaqësuesve të mediave vendore e ndërkombëtare për numrin e refugjatëve, për organizimin e sistemimit të tyre për nevojat emergjente, për trajtimin dhe furnizimet etj.

8. Organizimi i pranimit dhe i ndarjes së ndihmave, i mbrojtjes shëndetësore, i edukimit të fëmijëve, i trajnimit të kuadrove, i asistencës psiko-sociale, i jetës kulturore, argëtuese e sportive etj.

9. Organizimi i marrjes dhe i dhënies së informatave për vendosjen e kontakteve ndërmjet personave që e konsideronin njëri-tjetrin të humbur.

10. Organizimi i kthimit të organizuar në Kosovën e çliruar etj.

11. Evidentimi i personave që kanë nevoja për shërim jashtë vendit dhe organizimi për t'i dërguar në shërim.

12. Organizimi i përgatitjes dhe furnizimit me kartela refugjati.



Xh. Sheremeti duke bërë përzgjedhjen e materialeve nga dosjet.



**Ditarët e vizitave mjekësore në ambulancën e Shtabit të Shkallnurit 1998/99.**


REGJISTER I VIZITAVE NE SHTEPI (URGJENCA)

Një faqe nga regjistri i vizitave mjekësore në ambulancën e refugjatëve në Shkallnur 1998.



(1)

FORMULAR REGJISTRIMI PËR TË ARDHURIT NGA KOSOVA

Vendi i vendosjes SHKALLNUR - DURRËS

| Nr | Emri Atësi mbiemri | Datëlindja | Gjinia (F/M) | Vendi nga vjen Komuna/Fshati | Data e ardhjes | Pritësi Emri Atësia Mbiemri | Adresa e pritësit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | BUBE H. BERISHA | 1924 | F | [illegible] | [illegible] | [illegible] | SHKALLNUR |
| 2 | ZYHER Z. BERISHA | 1983 | M | -"-"- | -"- | -"- | -"- |
| 3 | [illegible] SH. -"- | 1970 | F | -"- -"- | -"- | -"- | -"- |
| 4 | [illegible] H. -"- | 1953 | F | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 5 | AFRIM A. -"- | 1995 | M | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 6 | [illegible] A. -"- | 1983 | M | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 7 | BESFORT A. -"- | 1988 | M | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 8 | [illegible] A. -"- | 1991 | M | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 9 | [illegible] A. -"- | 1980 | F | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 10 | [illegible] A. -"- | 1980 | F | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 11 | [illegible] A. -"- | 1989 | F | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 12 | [illegible] A. -"- | 1995 | F | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 13 | [illegible] Z. -"- | 1995 | M | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 14 | [illegible] Z. -"- | 1988 | F | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 15 | [illegible] Z. -"- | 1989 | M | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 16 | [illegible] Z. -"- | 1991 | F | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 17 | [illegible] A. -"- | 1968 | M | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 18 | [illegible] S. -"- | 1956 | M | -"- | 03.06.98 | [illegible] | -"- |
| 19 | [illegible] B. -"- | 1956 | F | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 20 | [illegible] B. -"- | 1985 | M | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 21 | [illegible] B. -"- | 1992 | M | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 22 | [illegible] A. -"- | 1980 | M | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 23 | [illegible] H. [illegible] | 1920 | F | PEJË | -"- | -"- | -"- |
| 24 | [illegible] B. -"- | 1964 | M | -"- | -"- | -"- | -"- |
| 25 | [illegible] S. -"- | 1967 | F | -"- | -"- | -"- | -"- |

[illegible]

Halit Sallaj

Verifikoi

86

## FORMULAR REGJISTRIMI PËR TË ARDHURIT NGA KOSOVA

Vendi i vendosjes SHKALLNUR - DURRËS

| Nr | Emri Atësi Mbiemri | Datëlindja | Gjinia (F/M) | Vendi nga vjen Komuna/Fshati | Data e ardhjes | Pritësi (emri Atësia Mbiemri) | Adresa e pritësit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | AGRON S. BERISHA | 1956 | M | DOBRIN - PODUJE | 30.8.98 | Hajri Fetahu | Shkallnur |
| 2 | THULANI I. -//- | 1990 | M | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 3 | RREZARTA I. -//- | 1993 | F | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 4 | RIFAT I. -//- | 1994 | M | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 5 | MUSA I. -//- | 1997 | M | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 6 | RAMADAN Q. SHABANI | 1949 | M | Peq | 30.8.98 | [illegible] | -//- |
| 7 | ZIZE B. -//- | 1956 | F | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 8 | GRANIT XH. -//- | 1982 | M | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 9 | ADIL XH. -//- | 1984 | M | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 10 | SULEJMAN Q. MATHI | 1952 | M | DOBRIN - PODUJEV | 30.8.98 | Ramadan Kojshi | L. 13 |
| 11 | HATMONE R. -//- | 1956 | F | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 12 | SOKOL S. -//- | 1975 | M | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 13 | JASMINE S. -//- | 1976 | F | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 14 | SOFE S. -//- | 1980 | F | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 15 | LINDITA S. -//- | 1985 | F | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 16 | LIRIJE S. -//- | 1990 | F | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 17 | ARBNOR S. -//- | 1992 | M | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 18 | HAMDI S. -//- | 1983 | M | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 19 | BAZIM F. -//- | 1910 | M | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 20 | HATMONE Z. -//- | 1916 | F | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 21 | FLORIM B. [illegible] | 1958 | M | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 22 | FIQRE H. [illegible] | 1981 | F | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 23 | AFRIM B. -//- | 1975 | M | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 24 | HATE B. -//- | 1976 | F | -//- | -//- | -//- | -//- |
| 25 | | | | | | | |





Shkallnur 1998, shtëpia e familjes Sheremeti dhe grupe refugjatësh duke pritur për t`u regjistruar, për t`u furnizuar ose për t`u informuar.

Nismë:

QENDRA SHQIPTARE
PËR TË DREJTAT E NJERIUT

## Puna e Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut në ndihmë të kosovarëve të vendosur në rrethin e Durrësit

Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut hartoi një program pune për t'u ardhur në ndihmë kosovarëve që u vendosën në rrethin e Durrësit pas raprezaljeve të bëra nga regjimi serb, në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare të Rehabilitimit për të Mbijetuarit e Torturës (QSHRMT).

Drejtori mjekësor i QSHRMT-së Dr. D. Totozani (psikiatër) dhe koordinatori i kësaj qendre A. Kati fillimisht më datën 9.06.1998 morën kontakt me Ministrin e Shëndetësisë për të rakorduar punët që ndihma të ishte sa më eficente. Inisiativa e qendrës sonë u prit mirë madje, u përgëzua nga ministri. QSHRMT u inkruadua në programin e Ministrisë së Shëndetsisë për të ndihmuar të ardhurit nga Kosova.

Më 17.06.1998 ne shkuam në qytetin e Durrësit, në Drejtorinë e Shërbimit Publik, ku drejtori Dr. Hider Koka na informoi shkurtazi mbi situatën. Sipas tij disa qindra kosovarë kishin ardhur në rrethin e Durrësit dhe ishin vendosur kryesisht në fshatrat Shkallnur dhe Shkozet. Shifra e saktë e tyre nuk dihej pasi kjo paraqiste mjaft vështirësi për shkak se të ardhurit nuk ishin të grumbulluar, përkundrazi të shpërndarë në shtëpitë e fshatarëve mbi bazë marrëveshjesh personale, pa kritere paraprake. Po sipas thënieve të drejtorit Hider Koka, një shtab pune, i ngritur në rreth nga pushteti lokal, pothuajse nuk kishte filluar nga puna.

Pasi morëm kontakt dhe me neuropsikiatrin e rrethit A.Ora, i cili prej kohësh bashkëpunon me qendrën tonë në ndihmë të ish të përndjekurve politikë, ne shkuam në fshatin Shkallnur, për të parë gjendjen konkretisht.

Në fshatin Shkallnur u informuam se nga vetë kosovarët ishte ngritur nja shtab pune emergjente për të ndihmuar të ardhurit nga Kosova.

Ne u takuam me z. Shefqet Sheremeti, kryetari i këtij shtabi organizativ si dhe me zotërinjtë Agron Sheremeti dhe mjekun pediatër Beqir Beqiraj, i ardhur po nga Kosova. Nga një bisedë e gjatë dhe e përzemërt e zhvilluar me ta, mësuam se ka rreth 700 të ardhur kryesisht gra, fëmijë dhe të moshuar të vendosur në Shkallnur, Arapaj, Plepisht dhe Shkozet. Gjithashtu rreth 300 të tjerë të vendosur në zonën e Rrashbullit.

Shtabi organizativ dukej i pakënaqur nga pushteti lokal dhe organizmat shëndetsore të rrethit lidhur me ndihmën që iu duhej dhënë të ardhurve nga Kosova. Me përpjekjet e tyre kishin arritur të merrnin një farë ndihme nga kisha katolike.

*Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut është një organizatë joqeveritare e regjistruar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës në 1992. QSHDNJ punon për monitorimin, dokumentimin, publikimin, edukimin, lobingun në parlament dhe popullarizimin e të*

Shtabi i ngritur i përbërë nga vetë kosovarët dukej se nuk kishte informacion të saktë e të hollësishëm mbi gjendjen shëndetsore të të ardhurve nga Kosova. Në qendër të vëmendjes së tyre ishin nevojat materiale të emergjencës si dyshekë, batanije, jastekë, ushqime dhe medikamente. Sidoqoftë nga thëniet e tyre e kryesisht nga mjeku pediatër Beqir Beqiraj, nga vizitat mjeksore, nga bisedat e zhvilluara prej stafit tonë në tërësi u konstatua se të ardhurit ishin tëpër të lodhur, të deprimiuar, të stresuar. Duke qenë se në përbërje shumica ishin gra dhe vajza na u kërkua prej tyre mundësia e ndihmës nga një mjek gjinekolog. Për këtë arsye u aktivizua mjekja gjinekologe me përvojë të madhe Vitore Popa.

Më 22.06.1998 u dërgua në Shkallnur ekipi i përbërë nga phathologu Dr. Izedin Çela, gjinekologia Dr. Vitore Popa së bashku me koordinatorin e QSHRMT-së (Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës) Adrian Kati si dhe financieri Kino Buxheli. Secili prej tyre u interesua në fushat respektive për të konkretizuar dhënien e ndihmës sipas mundësive.

Sipas konstatimeve të mjekut patolog personat e ekzaminuar paraqisnin një gjendje të rënduar psikologjike që shfaqej me fenomene të përjetimit të dhimbjes së kaluar, në mjaft raste shoqëruar me pesimizëm dhe ankth për njerëzit e tyre që jetojnë në Kosovë. Po ashtu në shumë të ekzaminuar u vu re ekzacerbim i simptomave të sëmundjeve kronike për shkak të terrenit të rënduar psikologjik. U ngrit nevoja e domosdoshme për furnizimin me një sasi medikamentesh të emergjencës, pasi blerja e tyre në farmaci nga vetë të ardhurit nuk ishte e mundëshme.

Nga mjekja gjinekologe Dr. Vitore Popa, që ka shkuar disa herë në atë zonë, janë bërë mjaft vizita gjinekologjije duke u ngritur njëkohësisht një seri problemesh emergjente për ushqimin e fëmijve të vegjël, për vaksinimin e tyre, për materiale të buta dhe për një seri medikamentesh të domosdoshme në fushën e pediatrisë dhe obstetrik gjinekologjisë. Në zonën e ekzaminuar ishin rreth:

| Numri i fëmijve | Mosha e fëmijve në vjeç |
|---|---|
| 27 | 0-1 |
| 15 | 1-2 |
| 126 | 2-7 |

QSHDNJ duke parë nevojat e tyre mundësoi dhënien e një ndihme 150.000 lekësh nga të cilat 100.000 për pajisje elektroshtëpiake dhe 50.000 lekë medikamente, pa përfshirë këtu shpenzimet e udhëtimit dhe të stafit që merren me këto probleme.

Lista e medikamenteve të emergjencës u hartua nga grupi i mjekëve të QSHRMT-së në bashkëpunim dhe me mjekun e ardhur nga Kosova Beqir Beqiraj, ku figurojnë 29 medikamente të domosdoshëm në fushat më të rëndësishme të specialiteteve mjekësore. Po ashtu u dërguan dhe materiale të tjera sanitare si aparat tensioni, garza, pambuk, shiringa të cilat u vunë menjëherë në dispozicion të mjekut pediatër Beqir Beqiraj i ardhur nga Kosova.

Mbi bazën e kërkesës së bërë nga Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut nga CRS-ja u vunë në dispozicion 460 pako me ushqime për fëmijë nga 0-7 vjeç.

Duke ndjekur në vazhdimësi gjendjen e të ardhurve nga Kosova në rrethin e Durrësit është vënë re se numri i tyre ndryshon nga dita në ditë. Nga biseda e zhvilluar në Shkallnur me anëtarët e shtabit të emergjencës u mësua se deri më datën 15.07.1998 në fshatin Shkallnur dhe lagjen 13 të plazhit të Durrësit figurojnë të rregjistruar 1100 persona, ndërsa 1000 të tjerë janë të shpërndarë në fshatrat Shkozet, Golem, Çeret dhe brenda në qytetin e Durrësit.

Kjo shpërndarje krijon vështirësi për t'u informuar saktësisht mbi gjendjen e shëndetit mendor dhe fizik të të ardhurve nga Kosova në rrethin e Durrësit. Nga shtabi i emergjencës ne jemi informuar saktësisht mbi moshën e personave të vendosur në fshatin Shkallnur dhe lagjen 13, ndërsa nuk kemi dijeni për të tjerët. Për t'u informuar për gjendjen e tyre shëndetësore u mendua që nga Qendra Shqiptare e Rehablitimit për të Mbijetuarit e Torturës të formulohet një pyetësor, i cili do t'u shpërndahet nga shtabi i emergjencës familjeve të ardhura nga Kosova dhe mbi bazën e të dhënave do të përpilohen programe pune ndihmë të tyre.

Tiranë, më 15.07.1998

Drejtore Ekzekutive

Kozara Kati



Kozara Kati dhe Kino Buxheli me Shefqet Sheremetin, në ambientet e Shtabit.



Adrian Kati me anëtarët e Shtabit, Agron Sheremetin dhe Beqir Beqirin (pediatër).



Ditarët e vizitave mjekësore në terren, Shkallnur 1999.

KRYQI I KUQ SHQIPTAR

# POLICE TRANSPORTI

Numri: 120 Transportuesi: IVECO

Nga: KKSH

Për në: K.K. [illegible] DURRES

| Nr. | Pershkrimi i mallit | Kodi | Origjina | Njesia | Sasia | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | oriz | | KKSH | kg | 300 | - |
| 2 | [illegible] | | - | - | 300 | 20400 lekë |
| 3 | Fasule | | - | - | 300 | 22800 lekë |
| 4 | Sapun | | - | copë | 1000 | 11000 lekë |
| 5 | Miell | | | kg | 3000 | 113.000 lekë |
| 6 | | | | | | |
| 7 | [illegible] | [illegible] | | | | |
| 8 | | | | | | |

Data: 7. 6. 99 [illegible] Firma e dërguesit

VEREJTJE :

Data: Firma e transportuesit

Marrë nga: Kryqi i Kuq [illegible]

Data: Firma e marrësit

VEREJTJE :

CATHOLIC RELIEF SERVICES
SHERBIMI KATOLIK LEHTESUES

*Proj.nr.: 264/806-98-004* *Tiranë, 29/06/98*
*Acc. Nr. 6102*

**Lënda:** Shpërndarje ushqimi për fëmijët Kosovarë - Shkallnur

Për dijeni:

**Kozara Kati**
Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut

**At Damian Kurti**

**Përfaqësuesve të refugjatëve / Shkallnur**

Dëshirojmë t'ju informojmë se,CRS, do të akordojë pako ushqimore 1 mujore për fëmijët Kosovarë të vendosur në Shkallnur.

Pakot janë të dhuruara nga Karitasi Hollandez dhe përmbajnë "Brinita Cereal".
Ato janë të paketuara në kuti kartoni me nga 20 pako secila.

Pakot jepen për 214 fëmijët Kosovarë të vendosur në Shkallnur, plus 59 pako për afërsisht 25 fëmijë që eventualisht mund t'i jenë shtuar numrit të mëparshëm.

Pakot duhet të shpërndahen në bazë të skemës së mëposhtme:

| Mosha (vjeç) | Nr. i fëmijëve | Nr. Pako/muaj | Nr. Pakove |
|---|---|---|---|
| 0-1 | 27 | 1 | 27 |
| 1 - 2 | 15 | 2 | 30 |
| 2 - 7 | 126 | 2 | 252 |
| 7 - 12 | 46 | 2 | 92 |
| E ndryshme | ~ 25 | Sipas grup moshës | 59 |

The Overseas Relief and Development Agency of the United States Catholic Conference

Furnizimi Miell kg 2500 Dhjetor 98

Prodhimi: Bukë

| | | |
|---|---|---|
| Data | 9 | kg 150 |
| -"- | 10 | -"- 170 |
| -"- | 11 | -"- 210 |
| -"- | 12 | -"- 180 |
| -"- | 13 | -"- 211 |
| -"- | 14 | -"- 180 |
| -"- | 15 | -"- 190 |
| " | 16 | " 150 |
| " | 17 | " 179 |
| -"- | 18 | -"- 200 |

SHUMA 1820 kg.

Nga mielli furnizuar është gjëndje për të prodhuar edhe ≈ 680 kg Bukë

Prodhuesi
Bardhyl Sela

CRS Albania

**GROUP INTAKE FORM –** Date: 12/08/98

Group Name: SHKALLNUR #M: 713 #F: 849

Town: DURRES # Total: 1562

Region: DURRES Code: ______

Kosovo Area Originated: KORRNA DEÇAN, GJAKOVA, KLINA MALISHEVA. Date in Albania: 9.8.98

**GENERAL CONTACT INFORMATION**

NGO Partner: CRS. CAPANAHUL, CARITAS
ORGANIZATAT

Refugee Liaison Leader 1: SHEFQETA SHEREMETI

NGO Contact: BASHRIJA
PERSONI KONTAKTIF

Refugee Liaison Leader 2: MAL SALLA

Kryeplak: ENVER KADRIMI
KRYEPLAKU

**EXTREMELY VULNERABLE INDIVIDUALS (EVI's)**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| # Pregnant Women: SHTATZENE | 16 | # Lactating Women: LEHONA | 12 | # Women needing Sanitary N's: NEVOJA PER HIGJIENE | 353 |
| # Babies < 6 mos.: BEBE E VOGLA | | # Physically Disabled: GJYMTUAR | | # Mentally Disabled: CREGULLIME MENDORE | |
| # Emotional Problems: PROBLEME EMOCIONALE | 24 | # Primary School Age: FEMIJE PER FILLORE | 4 | # Secondary School Age: F. PER 8-VJECARE | 320 |
| # Male Elderly (over 60): PLEQ | 70 / 96 | # Female Elderly (over 60): PLAKA | 240 / 54 | | |

**OTHER NEEDS / PROBLEMS**

TE TJERA NEVOJA / PROBLEME.

CRS Rep: ______________________

UNHCR 896-38-087-880 12-09-98

## REFUGEE RENOVATION CONTRACT NO. 02

This contract is between SHEFQET Q. SHEREMETI (The Community) and IRC.

Objective: Ndërtimi i murit për [illegible]

1. The Community agrees to complete the work described to achieve the above objective.

2. Total contribution by IRC for the work is: 800 $

3. The Community agrees to complete the work within 14 days from date of this agreement.

4. IRC agrees to make payment for the work as follows:

75 % of the total cost immediately as down payment

25 % of the total cost on completion of all the work.

5. The community agrees that the building renovated as the result of this project will be available for use rent free by registered Kosovan refugees for the duration of the current crisis.

6. Upon completion of the work, the continued operation and maintenance of the facilities will be the responsibility of the Community and the local authority.

For The Community: Sefqet Q. Sheremeti ............ Name/Date

For IRC: ............ 22/8/99 ............ Name/Date



Skallnur 1998, një çast nga zbarkimi i refugjatëve të porsaardhur.



Shkallnur 1998, ndarja e ndihmave.



Pamje e fshatit Shkallnur nga shtëpia e Sheremetëve ku vepronte Shtabi.



Pritje në zyrën e Shtabit, Shefqeti me vizitorët donatorë nga Holanda.



Aktivistët e Shtabit duke montuar tendën për pranimin e mallit për ndihma.



Momente nga arritja e mallit dhe shkarkimi.

## V E R T E T I M

Vertetoj se sot me 6.08.1998. ne emer te CRS ja kam dorezua Sjefqet Sheremetit nga Shkallnueri 75.000 lek per ndertimin e barakes qe nevojitet per shperndarjen e ndihmave te ikureve nga Kosova.

Pranoj

Shefqet Sheremeti

Dorezoj

Mons. Damjan Kurti

## V E R T E T I M

Vertetoj se soz me 10.08.1998. ne emer te CRS ja kam dorezua Shefqet Sheremetit nga Shkallnueri 69.000 lek per ndertinin e barkkes qe nevojitet per shperndarjen e ndihmave per te ikur nga Kosova.

Dorezoj

Mons. Damjan Kurti

Pranoj

Shefqet Sheremeti



Flower delivery information Durres 07.09.1998

The flour of Shkallnur will be delivered in three bakeries:

First bakery: Flour 200 bags Weight kgs 10000

Delivered by GJERGJ DUNGU [signature]

Received by [signature]

Second bakery: Flour 200 bags Weight kgs 10000

Delivered by GJERGJ DUNGU [signature]

Received by [signature]

Third bakery: Flour 240 bags Weight kgs 12000

Delivered by GJERGJ DUNGU [signature]

Received by [signature]



QENDRA SHQIPTARE
PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Rr. "Kont Urani", 10
Tel. +355 42 306 10
Fax: +355 42 383 68
E-Mail:
[illegible].TIRANA.AL

PROJEKTI : "Ndihma Shëndetësore dhe Edukimi për të Ardhurit nga Kosova të Vendosur në Rrethin e Durrësit"
( Raport dyjavor )

Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës, prej 2 muajsh punon për të ndihmuar të ardhurit nga Kosova, të vendosur në rrethin e Durrësit.

Për këtë u hartua dhe filloi projekti: ***"Ndihma Shëndetësore dhe Edukimi për të Ardhurit nga Kosova të Vendosur në Rrethin e Durrësit".***

Nën drejtimin e Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut është ngritur një grup pune me 2 ekipe; atë shëndetësor dhe të edukimit. Për çdo anëtar të grupit janë hartuar termat e referencës, të cilat saktësojnë organizimin e punës së grupit dhe detyrat e secilit.

## I. Aspekti shëndetësor

Që prej datës 16.07.1998, kur raportuam në selinë e UNICEF-it për punën e bërë në fushën e shëndetësisë e deri sot, e kemi shtuar shumë veprimtarinë për të njohur gjendjen shëndetësore të të ardhurve nga Kosova në rrethin e Durrësit si dhe për t'u dhënë ndihmën konkrete atyre që janë të sëmurë.

Ekipe të herë pas hershme, të përbërë nga stafi mjekësor, kanë parë nga afër gjendjen në Shkallnur, Rrashbull, Shkozet etj. Deri tani numri i të ardhurve nga Kosova në këtë zonë arrin rreth 2500 vetë.

Puna e Qendrës është përqëndruar më shumë në Shkallnur dhe në Lagjen 13 të Plazhit, aty ku dhe ka nisur veprimtaria jonë.

*Gjatë kësaj kohe kemi ofruar:*

- ndihmë konkrete mjekësore për çdo sëmundje që kemi konstatuar.
- një shërbim shëndetësor perspektiv mbi bazën e njohjes së gjendjes së shëndetit mendor e fizik të të ardhurve.

*Lidhur me pikën 1*

- Vazhdojnë të kryhen një sërë ekzaminimesh direkte mbi të ardhurit nga Kosova, që paraqesin ankesa në fushën patologjike, neurologjike, gjinekologjike dhe në atë të psikiatrisë.
  Në të ardhmen mendojmë të angazhojmë edhe specialistë të fushave të ndryshme.
- Vazhdojmë përpjekjet për të siguruar nga donatorë të mundshëm aparatet për vazhdimësinë e bërjes së dializës 20 vjeçarit Faruk Hulaj i cili vuan nga nefriti kronik me insuficiencë të rëndë renale.
- Po ashtu, kemi pasur problem me Gonxhe Elez Shehu, 28 vjeç, që vuan nga Hepatit infeksioz, nënë e 5 fëmijëve, e cila për arsye të kushteve të vështira ekonomike dhe sociale doli nga spitali kundër dëshirës së mjekëve. Për arsye se nuk i dinim adresën, na u desh shumë kohë për ta gjetur dhe për të biseduar që të rikthehej në spital.

*Në lidhje me pikën 2*

- Janë shpërndarë në rreth 100 familje pyetësorët e hartuar nga stafi ynë.
  Nga studimi i materialit të deritanishëm për 45 familje me 364 persona, duket se këta të ardhur janë me probleme shëndetësore kryesisht të sistemit kardio-vaskular, si dhe të sistemit gastro-intestinal, të sistemit nervor dhe më pak ato të sistemeve të tjera.

Është ky kontingjent që fillimisht do t'u nënshtrohet ekzaminimeve nga ana e stafit tonë.

Kanë filluar vizitat, të cilat bëhen 1 herë në javë në ambulancën që u ngrit dhe u pajis para pak ditësh me materialet dhe medikamentet e nevojshme me mbështetjen tonë financiare. Është planifikuar që të vizitohen të gjithë të ardhurit.

Rastet e urgjencës për të ardhurit janë vendosur të trajtohen nga poliambulancat dhe spitalet lokale, si edhe për popullsinë vendase që ndodhet në ato zona.

## II. Aktiviteti për edukimin e fëmijëve të ardhur nga Kosova të vendosur në Shkallnur të Durrësit

Puna filloi me regjistrimin e mësuesëve dhe të nxënësve kosovarë. Në këtë zonë deri tani ndodhen 18 mësues dhe rreth 150 fëmijë. Për çdo fëmijë është përcaktuar mosha si dhe klasa që do të ndjekë këtë vit mësimor. Për mësuesit janë marrë të dhëna për shkollën që kanë mbaruar, lëndën që japin etj.

Për edukimin e këtyre fëmijëve, për t'i mbajtur ato larg mjediseve familjare të rënduara me strese, për të mos i lënë ata rrugëve si dhe për të larguar streset, në këtë zonë kemi ngritur një shkollë verore.

Shkolla verore, e ngritur në shkollën e fshatit Shkallnur, zhvillon veprimtari sportive, kulturore, argëtimi dhe veprimtari për të drejtat e njeriut. Dy ditë në javë fëmijët i kalojnë në plazhin e Durrësit, ku përveç banjos së detit e të diellit bëjnë edhe veprimtari të tjera.

*Personeli i shkollës përbëhet:*

- Drejtori (që është edhe Drejtori i shkollës së fshatit)
- Zv/Drejtori - kosovar
- Mësues - 12

*Nga të cilët:*

  - Vendas - 3
  - Kosovarë - 9
- Numri i fëmijëve - 170

*Nga të cilët:*

  - Vendas - 40
  - Kosovarë - 130
- Grupe (klasa) - 8

Duhet theksuar se shkolla filloi me 60 fëmijë, dhe numri i tyre rritet çdo ditë, por janë marrë masa për të përballuar deri 200-250 fëmijë. Grupet janë të përbërë nga fëmijë vendas dhe kosovarë.

Veprimtaritë që zhvillohen sipas programit mbështeten nga ana organizative dhe metodike nga 4 mësues specialistë të shkollës "Sabaudin Gabrani", në Tiranë.

Kjo, që prej 5 vjetësh, është një shkollë pilot për edukimin e të drejtave të njeriut, nën drejtimin e Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut.

Shkolla verore në Shkallnur i zhvillon veprimtaritë e saja në bazë të një programi dhe me bazën materiale të nevojshme të siguruara nga Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut.

QSHDNJ po organizon punë që ta shtrijë veprimtarinë e saj, si për problemet shëndetësore ashtu dhe të edukimit, edhe në zonën e Shkozetit dhe të Rrashbullit.

Drejtore Ekzekutive

Kozara KATI



Pediatri Beqir Beqiraj nga Deçani, në ambulancën e Shtabit të Shkallnurit 1998.



P





Fëmijët e refugjatëve kosovarë në shëtitje nga Shkallnuri në Tiranë dhe Durrës 1998.



Refugjtë kosovarë, ekskursion nga Shkallnuri në Tiranë 1998.



Aktivitete sportive në plazh me të rinjtë, refugjatë në Shkallnur 1998.



Profesori i edukatës fizike, Agron Sheremeti, me një grup të rinjsh 1998.



Koncert i muzikës së lehtë për refugjatët në Shkallnur.





**Iftari për refugjatët gjatë ramazanit në Shkallnur.**


RILINDJA
E SHTUNE, 5 SHTATOR 1998 / 12

■ REPORTAZH

TE ARDHURIT NGA KOSOVA NE SHQIPERI

# Në Shkallnur organizohet jeta

Nga shtypi ditor i kohës për refugjatët e Shkallnurit.



Shpresat e popullit të Kosovës u lidhen ngushtë me UÇK-në, me unitetin e kombit shqiptar dhe me përkrahjen e miqve tanë amerikanë dhe euro-perëndimorë (shih fotot nga tubimet).




Refugjatët në Durrës në një tubim madhështor, komentet janë të tepërta.

## Klithmat, ofshamat dhe lotët

Popullit shqiptar, dhuna sllave dhe padrejtësia ndërkombëtare, i patën vënë kufij të mallkuar duke e ndarë në disa pjesë. Qysh në atë kohë nuk pushuan kurrë klithjet e tij për liri, drejtësi dhe mirëkuptim. Klithmat nga Kosova filluan të depërtojnë edhe nëpër veshët e shurdhër pas vitit 1981. U shtuan ato klithma pas vitit 1989, kur Jugosllavia filloi të shpërbëhet. Ndërgjegjja e botës së qytetëruar filloi të ngacmohet vetëm atëherë kur Kosova ishte dërrmuar dhe mbytur në ofshama, e "ofshama është djersa e shpirtit". Bota tashmë e kishte hedhur vështrimin drejt Kosovës, por nuk bënin ndonjë veprim në drejtim të shpëtimit të saj. Pritën derisa Kosova u mbulua me gjak e lot.

Masakrat në Qirez, Likoshan, Prekaz dhe Lubeniq ishin vetëm fillimi i luftës që pritej prej kohësh. U prit të ndodhë edhe Reçaku, që të skuqet ndërgjegjja e ftohtë e qendrave të forcës së botës. Nga të përkëdhelurit e Evropës, të denjur(dehur) nga gjaku në Kroaci dhe Bosnje, serbët nuk mund të ndaleshin pa e bërë të veten edhe në Kosovë. Paqja për ta nuk kishte kurrfarë kuptimi. "Serbia atë që e fiton me luftë e humbë me paqe" thoshin ata! "Vija e kuqe" për serbët u kuptua si nxitje për tejkalimin e saj. Ishin betuar se në Kosovë s'do të lënë më shumë se pesëqind mijë shqiptarë.

Në rrethanat që krijoi Serbia në Kosovë ekzistenca e forcave të NATO-s do të humbte kuptimin po të mos intervenonte. Ndodhi Konferenca e Rambujesë dhe pasuan bombardimet për të ndalur turrin e  forcave kriminele serbe. "Fatet e popujve të vegjël dalin nga dyert e fatkeqësive të mëdha"- ka thënë Ismail Qemali. U hapën dyert e fatkeqësive të mëdha.

Fillimin e bombardimeve nga NATO-ja serbët e përdorën si mundësi tjetër për të bërë spastrimin etnik të Kosovës dhe përgjegjësinë ta ndajnë me të tjerët. Piromanët e stërvitur i futën në veprim për ta bërë Kosovën shkrumb e hi.

Më 26 mars 1999 serbët filluan djegien e qytetit të Pejës. Atë ditë dogjën pothuajse të gjitha dyqanet e zejtarëve privatë. Të nesërmen u futën nëpër lagjet e qytetit. I nxirrnin shqiptarët në rrugë dhe u futnin zjarrin shtëpive. Masakruan edhe shumë njerëz. Kolona të gjata me gra, pleq e fëmijë të tmerruar vërshuan nëpër rrugët e qytetit. Përcjellësit e xhindosur serbë i drejtonin turmat e zgjedhura sipas shijes së tyre nëpër rrugët magjistrale në drejtim të Gjakovës ose të Rozhajës. I përdornin ato turma si mburojë të gjallë për lëvizjen e forcave ushtarake të tyre, të cilat rrezikoheshin nga bombardimet. Nga turmat e tilla nxirrnin edhe përfitime të tjera duke ua plaçkitur gjërat me vlerë si: stolitë, paratë, veturat, mjetet e tjera të transportit si dhe dokumentet personale apo "tapitë", për qëllimet e tyre djallëzore. Ndonjë burrë edhe e ndanin nga turma për të mos e kthyer më kurrë.

Shqiptarët e kanë të trashëguar nëpër breza uratën "Ta pastë lënë bereqetin!" si ngushëllim për ata që u digjet shtëpia. Natën e 27 marsit këtë uratë ia thash fqinjit tim Avni Kasapit, të cilit ia dogjën shtëpinë, gjersa ishte i strehuar në bodrumin e shtëpisë  sime, bashkë me familjet e tjera të fqinjëve (tridhjetë persona), që nuk deshëm të bashkoheshim me turmat e njerëzve të cilët gjatë ditës e braktisën qytetin. Akoma pa kaluar një orë, ma dogjën serbët shtëpinë, dyqanet dhe tre autobusët në parking. Ata, nëpër natën e errët e me shi të dendur, na

detyruan të dalim në rrugën Pejë- Gjakovë duke na përcjellë me fyerje, sharje të ndyra dhe me breshëri automatikësh mbi kokat tona.
Pas tri ditë qëndrimi në Strellc e Izniq forcat serbe na detyruan t`i bashkohemi një kolone të gjatë disa kilometra, drejt Prizrenit për në Kukës. Katër ditë rrugëtimi, nën presionin e pandërprerë fizik e psikik të kriminelëve serbë, përjetuam ndjenja të papërshkrueshme, si në ankthin e tmerrshëm të një ëndrre të keqe, që të brofë nga shtrati. Nga ankthet e tilla u liruam vetëm kur kaluam në anën tjetër të kufirit të Kosovës.
Në Shkallnur kemi arritur natën ndërmjet katër dhe pesë prillit. Që ditën e parë atje u bashkova me humanitarët, në shërbim të refugjatëve për të ndihmuar. Nga rrëfimet e atyre që e kishin përjetuar masakrën e Mejës, Krushës, Izbicës etj. kuptova se e keqja nuk njeh kufij dhe se mendja e kriminelëve është shumë pjellore. Ofshamat dhe lotët ishin përjetime të përditshme në qendrën e refugjatëve në Shkallnur, për djemtë e vrarë, për të dashurit e humbur, për fatin e Kosovës.
Angazhimi për t`ua zbutur dhimbjet e të tjerëve ishte ilaçi më i mirë për t`u liruar nga ankthet që na rëndonin shpirtin. Ishte futje në "Kopshtin e mirësisë".
Në fillim më angazhuan për t`i pritur dhe regjistruar refugjatët që arrinin rishtas. Pastaj për të bërë organizimin e nxënësve dhe mësimdhënësve, me qëllim të vazhdimit të vitit shkollor të ndërprerë në Kosovë me 19 mars, për trajnime të mësimdhënësve etj.
Në këtë pjesë të librit do të pasqyrohen faksimile të dokumenteve dhe fotografi të krijuara në ato rrethana, si dhe ndonjë rrëfim nga përjetimet e ndryshme.



Qendra Zejtare e Pejës pas aksionit të piromanëve serbë, mars 1999.



Krimet serbe mbi pronat e shqiptarëve, prona e NQSHH "SHEREMETI", Pejë 1999.



Disa donatorë në mesin e refugjatëve në ambientet e Shtabit të Shkallnurit.

Një pjesë e shënimeve të cilat i shkrova ditën e parë të angazhimit në Shkallnur.



Pjesë nga regjistri i refugjatëve në Shkallnur 1999.



Momente nga shpërndarja e bukës.



Çaste pritjeje për furnizime.

Komuniteti i kosovarve në SHKALLNUR, ARAPAJ dhe L.13
Grupi [illegible] për [illegible]
Shkallnur, 7.05.1999

# LAJMËRIM

Ditën 10.05.1999 në ora 16.30 në lokalet e shkolles fillore "Bajram Curri" në Plazh (L.13) Mbahet mbledhja e të gjithë mësimdhënësve të komunitetit Kosovar të strehuar në Shkallnur, Arapaj dhe në Lagjen.13 .

Në mbledhje do të konstituohet këshilli arsimor me organet e tij.

Do të percaktohen detyrat e nevojshme dhe të shqyrtohen mundësit për rifillimin e arsimimit dhe edukimit të nxënsve kosovarë të të gjitha niveleve arsimore që qenë të detyruar ta nderprejnë në Kosovë.

Luten mësimdhënsit të marrin pjesë në mbledhje!

Për grupin [illegible]
Xhemajl Sheremeti,prof

---

Qendra per trajtimin humanitar
Të të përndjekurve nga Kosova
Nr. 3/99
Datë. 29.04.1999
S h k a l l n u r

# LAJMERIM

Me datë 7 dhe 8 Maj 1999 organizohet seminar me temë: *"Edukimi i të drejtave të njeriut në shkollë"*.

Seminari organizohet nga *"Qendra shqiptare e të drejtave të njeriut"*- Tiranë.

Seminari mbahet në shkollën fillore "Bajram Curri" L.13 Plazh.

Ftohen të gjithë mësimdhënësit nga Kosova të ardhur gjatë vitit 1999 të marrin pjesë.

Për qendrën,
Pedagogu:Xhemajl Sheremeti

**Aktivitete për vazhdimin e vitit shkollor 1998/99 me refugjatët në zonën e Durrësit.**




**Shënimet në këtë regjistër i ka bërë personalisht secili pjesëmarrës në mbledhjen e mësimdhënësve kosovarë të mbajtur me 10.5.1999 në lokalet e shkollës "Bajram Curri" të plazhit të Durrësit.**





Grup i mësimdhënësve me trajneren nga Tirana V. Xhanari (në mes). Plazh 1999.

QSHDNJ nga Tirana, organizoi lloje të ndryshme të trajnimeve për mësimdhënësit, mjekët dhe intelektualët kosovarë. Temat e trajnimeve ishin: edukimi i të drejtave të njeriut në shkolla, dhënia e ndihmës psiko-sociale personave me strese apo trauma etj.



Grup i mësuesve dhe intelektualëve kosovarë me trajnerët nga Tirana e Durrësi.



Mësues dhe mjekë kosovarë me trajnerët nga Tirana pas trajnimeve për stresin dhe traumën.




U meremetuan disa shkolla për të integruar nxënësit nga Kosova. Njëra nga ato ishte në Shkozet. Në emër të refugjatëve përshëndet donatorët Sh. Sheremeti (para foltores).

**Nxënësit kosovarë që janë strehuar në Shqipëri gjatë vitit 1998 janë kyçur në mësimin e rregullt nëpër shkollat vendore të lokaliteteve përkatëse, kurse për ata që kanë arritur gjatë vitit 1999 është organizuar mësimi plotësues në fillim të qershorit nëpër shkollat vendore, por me mësues kosovarë.**
**Paralel me shkollën e rregullt, në disa lokalitete është organizuar edhe "Shkolla Verore Argëtuese" me fëmijë të përzier nga kosovarët dhe vendorët si dhe me mësues kosovarë e vendorë. Këtu do të paraqesim pjesë nga programi i "Shkollës Verore" të Shkallnurit dhe disa aktivitete të fëmijëve të kësaj Shkolle.**



**Lojë që i bën fëmijët të qeshin dhe të gëzohen.**



Ushtrim i valleve popullore.



Aktivitete në plazh.

Shkolla Verore - Argëtuese
Shkallnur - Durrës
Datë, 30.07.1999

Për QSHDNJ - Tiranë

Raporti perfundimtar

Shkolla Verore-Argëtuese në Shkallnur të Durrësit filloi punën me 4.05.1999 dhe e përfundoi me 30.07.1999.

Aktivitetet në këtë shkollë i zhvilluan 447 fëmijë nga të cilët:

- Nga Kosova 371 (femra 179, meshkuj 192)
- Nga Shqipëria 76 (femra 38, meshkuj 38)

Edukimin e fëmijve e bënë mësuesit

- Nga Kosova 4 mësues (femra 3, meshkuj 1)
- Nga Shqipëria 7 mësues (femra 4, meshkuj 3)

me ndërrime 15 ditëshe ose një mujore.

Puna në këtë shkollë u bë nën përkujdesjen e dy trainerve:

- Nga Kosova një (mashkull)
- Nga Shqipëria një (mashkull)

Edukimi dhe aktivitetet në këtë shkollë u zhvilluan në këto lëmi:

- Lëmia e të drejtave të fëmijve
- Lëmia artistike

- Lëmia krijuese dhe
- lëmia sportive

Në lëminë e të drejtave të fëmijëve u zhvilluan aktivitete përmes të cilave erdhi në shprehje edhe imagjinata e fëmijëve për të drejtat më të rëndësishme që ata duan t'i kenë. U edukuan ata për format e shprehjes dhe të mbrojtjes së të drejtave të tyre. Me krijimet e tyre përmes vizatimeve, punimeve letrare etj. ata lanë gjurmë të rëndësishme të edukimit në këtë fushë.

Në lëmin artistik fëmijët ishin të mrekullueshëm. Recitimet, këngët patriotike, vallzimet etj vërshuan dhe i dhanë gjallni ftohtit shkollimor të mbushur përplot me kosovar të përndjekur nga vatrat e tyre. Në fillim të muajit qershor fëmijët ekspozuan punimet e tyre krijuese në oborrin e shkollës (ambient të hapur) në pëlhura rreth e qark oborrit të shkollës ku krijuan një ambient që do të mbahet në mend për një kohë të gjatë. Aty ata ngritën edhe një podium ku dhanë një koncert artistik me recitime e këngë patriotike që ngritën në këmbë qindra shikues që patën mbushur oborrin e shkollës. Interpretimet ishin të nivelit më të lartë artistik.

Në lëmin krijues fëmijët lanë shumë punime letrare dhe modele në plastelinë, gazeta muri etj.

Në lëmimë sportive e argëtuese fëmijët mësuan shum lojna sportive, lojna popullore, shtie notimë etj. Lojnat që mësuan dhe ushtruan në shkollë dominonin nëpër lagjet e fshatit. Shkolla u bë e dashur për të gjithë fëmijët. Edhe ata fëmijë të fshatit apo kosovar që për shkage të ndryshme nuk vijuan këtë shkollë, her pas here bashkoheshin me fëmijët e shkollës në lojna apo në plath dhe e shtonin rëndësinë e shkollës (autoritetin e kësajë shkolle). Ekskurzioni që u organizua për vizitë në kalanë e Krujës u solli fëmijve kënaqësi të veçantë.

Të gjitha aktivitetet e fëmijve, mësuesit i pasqyruan në format më të mira dhe në fund, fotografitë më të dashura i ekspozuan në shkollë si kujtime të paharruara të një periudhe që nuk do të harrohet kurrë në këtë fshat.

Vlenë për t'u përmendur se kjo shkollë e filloi aktivitetin e saj në një klasë të shkollës katërvjeçare të fshatit. Ambienti për fillimin dhe zhvillimin e aktiviteteve ishte jashtëzakonisht i papërshtatshëm: klasa ishte shum e ngushtë me inventar të vjetruar.

Në oborrin e shkollës uzurpatorët kishin ngritë edhe mure me pronë shkollave të hyrjes në shkollë. Pjesën tjetër të oborrit e kishin mbushur me materjal ndërtimor e mbeturina të ndryshme që ishin të rrezikshme për fëmijët. Në dy klasat tjera të shkollës zhvillohej mësimi i rregullt me nxënësit e fshatit. Shtimi i fëmijëve kosovar vështirsoi në masë mjaft të madhe vazhdimin e mësimit. Në ambientin e shkollës nuk kishte banjo higjenike e as uj që të rrjedhte vazhdimisht.

Në këto kushte u angazhuan për punë mësues të trajnuar mirë në seminaret që kishte organizuar QSHDNJ, dhe atëherë kur dukej se shkolla do të dështonte, ata gjetën forma të përshtatshme për aktivizimin e fëmijëve dhe për një kohë shumë të shkurtër filluan sukseset e para. Fëmijët e aktivizuar filluan t'i japin gjallni fshatit. Nëpër rrugët e fshatit filluan të dëgjohen recitime e këngë të ushtruara në shkollë. Lojrat e mësuara këtu filluan të dominojnë nëpër rrugët dhe lagjet e fshatit. Objektivat e shkollës u arritën në shkallën më të lartë.

Shkëmbimi i përvojave ndërmjet mësuesve nga Kosova dhe Shqipëria kishte rëndësi të veçantë. Secili mësues kishte metodën e vet

të komunikimit me fëmijët dhe me sukses të jashtëzakonshëm përfitonin dashurinë e fëmijëve gjë që është komponenta më e rëndësishme në procesin edukativ.

Mbetet për për t'u dëshiruar permirësimi i ambientit shkollor në Shkallnur. Ky vend ka perspektivë të mirë për turizëm. Këtu kosovarët përjetuan ngrohtësinë dhe bujarinë e vendasve. Këtu ata gjetën ambient për zbutjen e dhëmbjeve për të afërmit e humbur, për shtëpitë e djegura, për përndjekjen nga vendëlindja e tyre që kosovarët e duan më shumë se çdo gjë.

Objektivat që u arritën këtu e sidomos në shkollën verore arsyetojnë investimet që u bënë.

Falënderojmë OSHDNJ për kontributin e jashtëzakonshëm.

Për shkollën verore të Shkallnurit

Xhemajl Sheremeti



Shkallnur 1999, ekspozita e punimeve të fëmijëve vijues të Shkollës Argëtuese Verore.



Pjesë nga programi artistik i fëmijëve të Shkollës Verore, dhënë për refugjatët. Kushtet që shfrytëzuan ata për të bërë diçka me vlerë nuk duan koment.





Emocione të jashtëzakonshme ngacmuan fëmijët me programin e tyre në ato kushte.




Çast pushimi i mësuesve të Shkollës Verore gjatë ekskursionit në Kalanë e Krujës, 1999.



Krujë 1999, nga ekskursioni i fëmijëve refugjatë të strehuar në Shkallnur.



Drejtori i shkollës së Shkallnurit me mësues nga Durrësi dhe Tirana, vizitë Shtabit.

**Viti shkollor 1998/99 në Kosovë u nderpre nga lufta në muajin Mars. Për nxënësit nga Kosova që ishin të strehuar në Rrethin e Durrsit, u organizua vazhdimi i vitit shkollor nga një Qershori. U liruan për këtë qëllim disa shkolla në Durrës, në Shkozet, në Plazh dhe në Shkallnur. Në fotot më poshtë shihet klasa VIII 1 dhe kolektivi i arsimtarëve që u formua për mësimdhënie në Plazh. Të ghithë nga lokalitete të ndryshme të Kosovës.**





Nxënësit nga Kosova të cilët ishin strehuar në Rrethin e Durrsit gjatë vitit 1998 u sistemuan nëpër klasat përkatse të shkollave vendore.



Një nga klasat e gjimnazit "Naim Frashëri" në Durrës ku vijuan edhe kosovarët,1999.

Maturantja e gjimnazit "Bedri Pejani" nga Peja, Arbërore Sheremeti, ditën që po zhvillohej "Beteja e Logjës" në gusht të vitit 1998, bashkë me një pjesë të familjes u largua nga Peja nëpër bjeshkët e Lipës dhe pas tri ditë rrugëtimi kishte arritur të bashkohet me pjesën tjetër të familjes në Shkallnur. Vitin shkollor e kishte filluar në gjimnazin "Naim Frashëri" të Durrësit. Në tetor të atij viti ishte kthyer në Pejë bashkë me tre vëllezërit duke menduar se u bë një marrëveshje për përfundimin e luftës në Kosovë. Ishte mërzitur në Shkallnur pa prindërit dhe me streset e mëdha të jetës si refugjat. Ishte fati i saj të përjetojë tmerret e luftës në Kosovë. Përjetoi djegien e shtëpisë së vet, të "shtëpi-shkollave", tmerret nga bombardimet, tmerret e kolonës së refugjatëve nëpër rrugët e Kosovës etj. Në Shkallnur arriti përsëri me 5.4.1999 por tani bashkë me prindërit. Asaj iu mundësua të vazhdojë mësimet në klasën që kishte vijuar deri në tetor dhe pas suksesit të treguar iu dha mundësia të futet edhe në provimet e maturës, të cilat i kreu gjithashtu me sukses. Në manifestimin tradicional të shkollës "Rrugë të mbarë maturantëve" ajo mbajti një fjalim të shkurtër dhe prekës:

SHKOLLA E MESME E PERGJITHSHME
"NAIM FRASHERI"
DURRES

# Jeta ime në katër vite
(Mbresa nga shkolla)

Emër, mbiemër: [illegible]
Klasa: [illegible]

Durrës më, 9 Korrik 1998

Të dashur prindër, pedagogë dhe [illegible] të [illegible]:

Jam shumë e [illegible] që më u dha rasti të [illegible] me ju përfundimin e provimeve të pjekurisë. [illegible]

[illegible]

Bashkëmaturantë të mi! [illegible]

[illegible]

[illegible] jeta nxënëse të mija!

Ju faleminderit!



Arbërorja duke lexuar para maturantëve të gjimnazit "N. Frashëri" në Durrës 1999.



Arbërorja me profesoreshën kujdestare dhe prindërit pas fjalës së mbajtur në manifestim.



REPUBLIKA E KOSOVES
SHPERNDARJA E NDIHMAVE NE MONEDHE
DATA 13.05.98

SHKALLNUR - DURRËS.

Dokument për ndihmat e dhëna nga Republika e Kosovës refugjatëve në Shkallnur.




Disa lista me nënshkrimet e refugjatëve për ndihmat e pranuara nga R. e Kosovës.



**Regjistri i familjarëve refugjatë të cilët strehimin e kanë siguruar me qira.**




Lista me kërkesat për të ndihmuar gjetjen reciproke të refugjatëve të ndarë.



26.06.1999

LISTA E TË SËMURËVE

1. IDRIZ SHEHU (JUNIK) 100 VJEÇ /PLAZH L 13
- KARROC PËR INVALID I /PAJTIM MIFTARI
2. HAKI SAHITI (GJAKOVË) 49 VJEÇ /SHKALLNUR DURRË
- TRANSPORT NË RELACION DURRËS-TIRANË dhe anasj
Përkujdesje mjeksore
3. AVDIJE (Ibrahim) KRASNIQI (PRIZREN) V.L. 1957
- Te karburanti Arazaj - Petrit Tota.
- Karroc për invalid. Përkujdesje mjeksore
4. XHEMILE (KURTISH) KRASNIQI (Prizren) V.L. 1919
- Te karburanti Arazaj Petrit Totaj.
Është me kockë të thyer në këmbë.
5. SHAHE PLLANA (e vjetër) (MITROVICË)
|Shkallnur Durrës Te Ejup Hoxha| Karroc për invalid. Përkujdesje
6. ALBIN (RAMË) OSMANI (13 vjeç) Gjakovë. i PARALIZU
Shkallnur Durrës. Te Abaz Kapllani.
7. DERVISH SELIMI (65 VJEÇAR). Karroc për invalid.
Përkujdesje mjeksore. Me të meta psiqike.
NIVOKAZ. GJAKOVË. i vendosur në SHKALLNUR.



1. Deçani (3192)
1. Baballoqi 135
2. Beleg 39
3. Carabreg 2[illegible]
4. Dashinoci 9
5. Deçani 267
6. Dranoci 43
7. Dubovik 58
8. Dubrava 14
9. Glloqani 73
10. Gramaqeli 86
11. Gjocaj 20
12. Hulaj 7
13. Irzniqi 114
14. Isniqi 140
15. Jasiqi 9
16. Junik 622
17. Kodrali 12
18. Kodrali 37
19. Lloca 5
20. Lumbardhi 45
21. Loçani 49
22. Luka 89
23. Maznik 5
24. Pobrgja 320
25. Prapaqani 42
26. Prekolluk 23
27. Prilepi 90
28. Rastavica 100
29. Rafshi 20
30. Sllupi 29
31. Strellci 340
32. Shaptej 12
33. Voksh 61

2. Drenasi (155)
1. [illegible] 6
2. Drenasi 29
3. Kopiq 4
4. Opoja 22
5. Plava 47
6. Skajme 31
7. [illegible] 8
8. Bellobrad 2

3. Fushë Kosova (80)
1. Bardhi i madh 34
2. Fushë Kosova 18
3. Dobreva 10
4. Lismiri 6
5. Miradi e E. 12

4. Ferizaj (16)
1. Doganaj 5
2. Ferizaj 11

5. Glloqovci (36)
1. Baica 10
2. Glloqovci 3
3. Likoshani 6
4. Lapushniku 8
5. Dollai 9

6. Gjakova (2618)
1. Babaj i Bokës 219
2. Bardhaniqi 9
3. Beci 29
4. Bejoku 24
5. Bohitka 149
6. Brovina 58
7. Cermjani 46
8. Damjani 41
9. Deva 30

10. Dobreshi 107
11. Dujaka 29
12. Dushkaja 29
13. Firaja 18
14. Gergoci 26
15. Godeni 7
16. Greqina 5
17. Gjakova 721
18. Gjonaj 1
19. Hereq 54
20. Jabllanica 2
21. Koronica 1
22. Koshare 17
23. Kralani 25
24. Kramovik 17
25. Lipovec 6
26. Meqiq 43
27. Morina 55
28. Nivokaz 32
29. Osek 18
30. Paci 20
31. Piskota 12
32. Ponoshec 60
33. Popoci 17
34. Rakovina 21
35. Ramoci 49
36. Rogova 16
37. Rugova 39
38. Rraci 12
39. Skivjani 134
40. Smolica 49
41. Stubëlla 32
42. Shermeti 30
43. Shishmani 30
44. Zylfaj 12
45. Zhebeli 3

Vendbanimet nga erdhën refugjatët në Shkallnur.

7. Gjilani (28)

1. Gjilani 13
2. Kamenica 3
3. Terpeza 6
4. Uglari 6

8. Istogu (233)

1. Banja 7
2. Istogu 55
3. Kashica 67
4. Kovraga 7
5. Lubova 7
6. Lukavci i Begut 15
7. Muzhevina 5
8. Rakoshi 10
9. Rudica 34
10. Saradurani 6
11. Trubolaci 10

9. Kaçaniku (14)

1. Kaçaniku 14

10. Klina (125)

1. Bokshiqi 8
2. Dollova 10
3. Drenovci 6
4. Dushi 12
5. Jashanica 34
6. Klina 14
7. Kpuzi 1
8. Perpeva 4
9. Qeskova 6
10. Qupeva 28
11. Siciska 8

11. Lipjani (7)

1. Gadimja 4
2. Smollusha 3

12. Malisheva (276)

1. Banja 54
2. Bellacerka 10
3. Bellanica 12
4. Bilusha 3
5. Carralluka 10
6. Dobrevo 3
7. Drenobili 12
8. Gajrani 16
9. Kravasari 1
10. Malisheva 27
11. Ostrozubi 24
12. Shkoza 54
13. Vrenezi 29

13. Mitrovica (266)

1. Kiçiqi 1
2. Haziqi 3
3. Mekina 1
4. Mitrovica 214
5. Rahova 10
6. Stantërgu 1
7. Shipoli 19
8. Vinarci 2
9. Zhabari 5

14. Obiliqi (29)

1. Dardhishta 16
2. Hade 8
3. Obiliqi 5

15. Peja (1650)

1. Barani 29
2. Berliqi 47
3. Brezhnica 38
4. Bugani 41
5. Dobërdoli 12
6. Dubova 13
7. Ganbovci 9
8. Jabllanica e Madhe 10
9. Jabllanica e Vogël 15
10. Klinina 23
11. Kodradiqi 45
12. Kosuriqi 4
13. Kryshec 2
14. Leshani 22
15. Loxha 26
16. Lubeniqi 44
17. Lutogllava 23
18. Nabergjani 30
19. Naberdani 20
20. Novoselo 3
21. Pavlani 23
22. Peja 942
23. Raushi 18
24. Rashiqi 51
25. Raushiqi 117
26. Qallapeku 13
27. Vranoci 18

16. Podujeva (33)

1. Lluga 10
2. Lupçi 8
3. Obranxha 8
4. Podujeva 7

17. Presheva (9)

1. Peçinaj 2
2. Presheva 7

18. Prishtina (266)

1. Hajvalia 1
2. Mihajanit 5
3. Prishtina 260

19. Prizreni (1272)

1. Hëmonje - - - 101
2. Billagi - - - 7
3. Dedaj - - - 7
4. Duhanova - - 55
5. Hoça - - - 60
6. Jeshkova - - 27
7. Kushnin - - - 29
8. Kuku - - - 16
9. Korisha - - - 83
10. Landovica - 12
11. Leskoveci - - - 3
12. Lezi - - - 17
13. Lubigeva - - 26
14. Lubizhda - - 29
15. Mazreku - - - 8
16. Medveci - - - 21
17. Nashec - - - 10
18. Pirana - - - 9
19. Prizreni - - 578
20. Randobrava - 31
21. Romaja - - - 12
22. Tupeci - - - 7
23. Vlashnja - - 24
24. Vranici - - - 29
25. Vrini - - - 24
26. Zojzi - - - 27
27. Zaplluzha - - 8
28. Zymi - - - 4
29. Zhuri - - - 45

20. Rahoveci (357)

1. Bellacevci - - - 4
2. Brestovci - - 23
3. Celina - - - 20
4. Krusha e Madhe 132
5. Nagavci - - 47
6. Opteriusha - - 19
7. Pollusha - - - 8
8. Peshteli - - - 5
9. Rrifllaku - - - 5
10. Rahoveci - - 20
11. Xërxa - - - 24

21. Skenderaj (117)

1. Baijo - - - 8
2. Klina - - - 5
3. Kllodernica 7
4. Likoci - - - 1
5. Lausha - - - 7
6. Obrinje - - - 9
7. Prekaz - Polac - 16
8. Qitaku - - - 5
9. Skenderaj - - 32
10. Sellogeriçka 8
11. Vitaku - - - 5
12. Vojnicu - - - 5

22. Suhareka (1157)

1. Bllaca - - - 42
2. Budakova - - 19
3. Bukoshi - - - 61
4. Bërzhala - - - 14
5. Bobishtani - - 7
6. Dubova - - - 1
7. Gelanci - - - 41
8. Greiçoci - - 107
9. Grejkoci - - - 3
10. Gjinoci - - 88
11. Mushtishti 110
12. Neperbishti 23
13. Peçani - - - 14
14. Reçani - - - 82
15. Reshtani - - 19
16. Samadraxha 1[illegible]
17. Savrova - - - 2[illegible]
18. Sellaci - - - [illegible]
19. [illegible] - - - [illegible]
20. Sllapuzhani - 3[illegible]
21. Sopia - - - 37
22. Shiroqina - - 11
23. Studençani - 116
24. Suhareka - - 235
25. Shkipoli - - - 5
26. Tupliçani - - 4
27. Vraniqi - - - 19
28. Vërshici - - - 6

23. Viti (5)

1. Pozharani - - - 5

24. Vushtria (24)

1. Samadrexha - - - 9
2. Vushtria - - - 15

**Shënimet nga tri faqet e fundit u nxorën nga fletoret e gjetura të cilat janë përdorur për regjistrimin e refugjatëve. Vërehet se nuk janë ruajtur të gjitha fletoret e tilla.**



| Nr. | Komuna | Vendbanime | Persona |
|---|---|---|---|
| 1. | Deçani | 33 | 3192 |
| 2. | Dragashi | 8 | 155 |
| 3. | Fushë Kosova | 5 | 80 |
| 4. | Ferizaji | 2 | 16 |
| 5 | Gllogovci | 5 | 36 |
| 6. | Gjakova | 45 | 2618 |
| 7. | Gjilani | 4 | 28 |
| 8. | Istogu | 11 | 223 |
| 9. | Kaçaniku | 1 | 14 |
| 10. | Klina | 11 | 125 |
| 11. | Lipjani | 2 | 9 |
| 12 | Malisheva | 13 | 276 |
| 13. | Mitrovica | 9 | 256 |
| 14. | Obiliqi | 3 | 29 |
| 15. | Peja | 27 | 1650 |
| 16. | Podujeva | 4 | 33 |
| 17. | Presheva | 2 | 9 |
| 18. | Prishtina | 3 | 266 |
| 19. | Prizreni | 29 | 1282 |
| 20. | Rahoveci | 11 | 357 |
| 21. | Skenderaj | 12 | 117 |
| 22. | Suhareka | 28 | 1157 |
| 23. | Vitia | 1 | 5 |
| 24. | Vushtria | 2 | 24 |
| Totali | 24 | 271 | 11956 (+1624 = 13580) |

Vërejtje: Mungon një regjistër (fletore) me 1624 persona

Problem i veçantë ishte furnizimi i refugjatëve me kartela identiteti. Ata ndiheshin të lënë pas dore, pas asgjësimit të dokumenteve të tyre nga milicia serbe. Shumë prej refugjatëve i ndërronin shpesh vendbanimet dhe ishte vështirë të mbaheshin shënimet. Megjithatë u bë diçka edhe në atë drejtim.



**Qendra SHKALLNUR 1**

**Familjet që janë pajisur me kartë**

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shefqet | Sheremeti | 6 | 51 | Riza | Ofluri | 6 | 101 | Taf | Jasiqi | 6 |
| 2 | Agron | Sheremeti | 4 | 52 | Shkurta | Cocaj | 3 | 102 | Rifat | Guraziu | 5 |
| 3 | Bakir | Bajri | 2 | 53 | Dervish | Dervishaj | 4 | | | | |
| 4 | Kadri | Temava | 6 | 54 | Sylejman | Dervishaj | 3 | | | | |
| 5 | Ramadan | Sheremeti | 5 | 55 | Blerim | Shehu | 4 | | | | |
| 6 | Xheladin | Beqiraj | 8 | 56 | Ramë | Hysenaj | 4 | | | | |
| 7 | Leonor | Shala | 1 | 57 | Ali | Hajdari | 5 | | | | |
| 8 | Azem | Shala | 4 | 58 | Zimer | Buzhala | 9 | | | | |
| 9 | Haki | Sahiti | 7 | 59 | Agron | Ademaj | 4 | | | | |
| 10 | Qamil | Limani | 5 | 60 | Bajram | Avdimetaj | 6 | | | | |
| 11 | Beqjet | Magjuni | 4 | 61 | Ahmet | Avdimetaj | 2 | | | | |
| 12 | Nimon | Qorraj | 7 | 62 | Brahim | Rama | 8 | | | | |
| 13 | Sahit | Qorraj | 5 | 63 | Hasan | Halitaj | 6 | | | | |
| 14 | Shkurte | Bajrami | 6 | 64 | Ramiz | Avdija | 9 | | | | |
| 15 | Fatmir | Aliu | 3 | 65 | Blerim | Gorani | 1 | | | | |
| 16 | Sokol | Sadriu | 6 | 66 | Gjemaj | Suka | 7 | | | | |
| 17 | Faze | Sadriu | 5 | 67 | Hagji | Ahmeti | 6 | | | | |
| 18 | Arsim | Sheremeti | 5 | 68 | Muhamet | Hadergjoni | 2 | | | | |
| 19 | Shuaib | Kajtazi | 1 | 69 | Nezir | Gecaj | 1 | | | | |
| 20 | Qenan | Stublla | 1 | 70 | Sadri | Halilaj | 6 | | | | |
| 21 | Qazim | Hoxha | 10 | 71 | Avdi | Halilaj | 8 | | | | |
| 22 | Daut | Ahmetaj | 6 | 72 | Ramiz | Shala | 8 | | | | |
| 23 | Ramë | Begbogaj | 6 | 73 | Astrit | Krasniqi | 8 | | | | |
| 24 | Mehmet | Pepshi | 4 | 74 | Adem | Gjocaj | 5 | | | | |
| 25 | Avdyl | Hajdari | 6 | 75 | Naser | Llolloluni | 10 | | | | |
| 26 | Imer | Orini | 5 | 76 | Isuf | Maka | 9 | | | | |
| 27 | Lumnije | Dobigaj | 5 | 77 | Musë | Dauta | 7 | | | | |
| 28 | Luan | Gashi | 1 | 78 | Nushe | Loshaj | 4 | | | | |
| 29 | Naser | Daci | 5 | 79 | Rexhep | Alaj | 5 | | | | |
| 30 | Rrushe | Mahmutaj | 2 | 80 | Sofije | Islamaj | 8 | | | | |
| 31 | Ahmet | Mahmutaj | 4 | 81 | Neki | Goqi | 6 | | | | |
| 32 | Miftar | Mazrekaj | 4 | 82 | Ali | Sylaj | 6 | | | | |
| 33 | Sadije | Qufaj | 3 | 83 | Bajram | Halilaj | 3 | | | | |
| 34 | Nurije | Qestaj | 2 | 84 | Halil | Demiri | 6 | | | | |
| 35 | Shkurta | Hebibi | 1 | 85 | Remzi | Ymeri | 6 | | | | |
| 36 | Sadri | Bajrami | 5 | 86 | Bajram | Gashemi | 7 | | | | |
| 37 | Smajl | Avdyli | 4 | 87 | Kushtrim | Sela | 2 | | | | |
| 38 | Xhemajl | Sheremeti | 6 | 88 | Hashim | Ajvazi | 8 | | | | |
| 39 | [illegible] | Shala | 4 | 89 | Halit | Selmani | 7 | | | | |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | 5 | 90 | Avdi | Halilaj | [illegible] | | | | |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | 5 | 91 | Kamer | Jashari | [illegible] | | | | |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | 4 | 92 | Ismet | Mataj | [illegible] | | | | |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | 8 | 93 | Asim | Krasniqi | [illegible] | | | | |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | 8 | 94 | Cenë | Bajrami | [illegible] | | | | |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | 5 | 95 | Miradije | Morina | [illegible] | | | | |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | 1 | 96 | Adem | Isufi | [illegible] | | | | |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | 7 | 97 | Luzim | Hagjiu | [illegible] | | | | |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | 5 | 98 | Xheladin | Jasiqi | [illegible] | | | | |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | 1 | 99 | Myhedin | [illegible] | [illegible] | | | | |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | 6 | 100 | Beqir | Shala | [illegible] | | | | |

Për organizimin e refugjatëve në Shkallnur, për furnizimet me ushqime e mjete të tjera të nevojshme, për kujdesin shëndetësor etj. u interesuan shumë përfaqësues të shteteve, të organizatave humanitare dhe të mediave të ndryshme informative. Më poshtë shihen fotot e disa përfaqësuesve të tillë të cilët e vizituan Shkallnurin në atë kohë:



Përfaqësues nga SHBA me dr. Skënder Shalën në ambulancën e refugjatëve.



Donatorë nga Nju-Jorku në depon e furnizimeve për refugjatët në Shkallnur.



Delegacion i organizatës humanitare amerikane CRS.



Sevime Arbana dhe Fabiola nga shoqata “Në dobi të gruas shqiptare” nga Tirana.



Dy humanistët suedezë në skaje, gazetarja angleze dhe mjeku nga Tirana.



Përfaqësuesi në OKB nga Koreja Jugore.


Nga Emiratet Arabe .


Donatorë nga Kanada.


Humanistja Dynek nga Holanda. Donatore për edukimin dhe shëndetësinë.



Ushtarakë nga NATO.



Mjekë ushtarakë nga NATO, me mjekët e ambulancës së refugjatëve.


Gazetare nga Londra.


Gazetare nga Irlanda.



Psikolog nga Universiteti i Zagrebit.



Bankierja nga Londra, humanist gjerman dhe humanist suedez



Atasheu holandez në Tiranë.




Drejtoresha gjenerale e CRS në Tiranë

**Disa rrëfime të anëtarëve të Shtabit të Shkallnurit:**

**Shefqeti: "Erdhën mbi njëzet të përndjekur nga Smolica e Gjakovës bashkë me errësirën e natës, të lodhur nga uria dhe rruga e gjatë. Nga lista e shtëpive të lira nuk kishte mbetur asnjë vend për t`i strehuar. Ja mësyna hotelit "Florida", ngase i kisha edhe disa të holla që i ruaja për raste emergjente. U mora vesh me pronarin që t`u sigurojë darkën, fjetjen dhe mëngjesin. Nuk bisedova fare rreth çmimit. U çova herët të nesërmen dhe sapo gjeta strehimin për ta në Shkozet u ktheva në "Florida". Kur e pyeta pronarin për shpenzimet dhe nxora paratë për të shlyer borxhin, pronari mu drejtua:- 'more burrë, edhe unë jam shqiptar, ma pranoni këtë si një nder të vogël nga ana ime'. Me këtë gjest më dha një guxim të madh, mund t`i trokitja për ndihmë, me ballë të hapur secilit shqiptar.''**

**Mala: "Duke u kujdesur në Shtab erdhën disa 'goldonë' plot me refugjatë nga Malisheva dhe nga Rahoveci. Nuk kisha të regjistruar asnjë shtëpi të lirë, fluksi ato ditë ishte shumë i madh dhe fshati Shkallnur ishte tejmbushur. Më tha dikush se një hotel te Shkëmbi i Kavajës sapo ishte ndërtuar dhe akoma nuk kishte filluar të punojë. I mora refugjatët me ata traktorë të vegjël dhe i çova atje. Ishte vetëm një rojtar. Më tha se pronari është nga një fshat i Gjakovës dhe punon jashtë. Nuk ma hapi derën por unë e hapa pa e pyetur fare dhe i vendosa aty më shumë se tridhjetë të ardhur. Pas dy javësh erdhi pronari dhe më takoi. U ndjeva në siklet për që i kisha bërë. Pronari e kuptoi gjendjen time dhe shpejtoi të ma ndërpriste ankthin që kisha:- 'Faleminderit o burrë që nuk më ke lënë me u koritë' dhe më mori për të më gostitur në shenjë falënderimi."**

**Ramadani: "Pas mesit të natës zakonisht rrija unë kujdestar në Shtab, meqë të tjerët lodheshin shumë me punët e ditës. Një natë rreth orës dy erdhi një kamion i madh me mbi tridhjetë refugjatë, nga Nivokazi i Gjakovës. Ishte natë e ftohtë dhe nuk kisha ku t`i strehoj të ardhurit. Pronari i kamionit kërkonte t`i zbriste ata nga kamioni dhe të kthehej për Kukës që të merrte ndonjë turrë tjetër. Nuk e lejova t`i zbriste deri në mëngjes meqë kishin shumë fëmijë dhe bënte ftohtë. Ishin shumë të uritur, iu ofrova bukë dhe konserva nga depoja e refugjatëve. Vozitësi nga Kukësi insistonte të kthehej dhe arsyetohej se kështu e nxirrte bukën e fëmijëve. Më tha se as ti nuk rri këtu pa të paguar dikush. Kur i thash se unë rri kështu çdo natë vetëm për t`i ndihmuar këta që kanë nevojë, bile edhe bukën dhe gjërat e tjera ua siguroj falas, ai u emocionua shumë dhe mu drejtua: -'qe besa edhe unë këtë natë dua të rri me ty dhe ndihem i nderuar për këtë''.**

**Arsimi: "Një telefonatë nga Zvicra na njoftoi se katër djem nga fshati Baballoq i Deçanit ishin plagosur në kufi, para katër-pesë ditësh dhe dergjeshin në spitalin e Bajram Currit, pa ilaçe dhe pa përkujdesjen e duhur. Na u lutën t`i lajmërojmë familjarët e tyre për t`u dalë në ndihmë. E mora Zymerin, kushëririn e njërit prej tyre, dhe shkova në Zyrën e Kosovës, te Ramajliu, për të kërkuar ndihmë. Ramajliu na i dha të hollat për t`i marrë dy taksi vetura dhe t`i sjellim ata në Tiranë. I gjetëm të plagosurit me të vërtetë në gjendje të mjerueshme. Duhej që kthimin ta bëjmë me traget. Në traget na liruan dhomën e personelit që t`i shtrijmë të**

plagosurit dhe nuk i morën paratë për udhëtim. Në spitalin ushtarak të Tiranës na pritën aq mirë sa i vendosën ata në një repart të veçantë pa pacientë të tjerë por nuk kishin ilaçe të nevojshme. I morëm mjekët dhe ilaçet nga ambulanca e Shtabit të Shkallnurit dhe u ndihmuam. Pas disa ditësh njërin nga ata duhej ta dërgonim në Zvicër për shërim të mëtejmë. Biletën e udhëtimit me aeroplan e pagoi Zyra e Kosovës në Tiranë."

Agroni: "Në orët e vona të natës doli në TVSH Musa Ulqini me një apel për të gjithë ata që kanë mjete transporti, që të nisen për Kukës nga se atje kanë arritur tërë popullata e Pejës dhe Gjakovës dhe kanë nevojë të transportohen nëpër qytete të ndryshme të Shqipërisë. Morëm me Arsimin dy vetura, i mbushëm me bukë e konserva dhe rreth orës një u nisëm për Kukës. Në kthesat e Mirëditës e takuam kolonën e gjatë të automjeteve me plot refugjatë nga Peja. Na informuan se e kishin parë duke u djegur shtëpia jonë në Pejë, por nuk ditën asnjë informatë për anëtarët e familjes sonë që ishin akoma atje. Shpërndamë aty një sasi të bukëve dhe vazhduam rrugën. Në Kukës të gjitha rrugët ishin mbushur me traktorë, kamionë dhe këmbësorë pa mjete transporti. Brenda disa minutave i shpërndamë të gjitha bukët, i mbushëm të dy veturat me refugjatë dhe u kthyem në Shkallnur. Pa pushuar akoma, një telefonatë nga Amerika (R. Gashi) na u lut të shkojmë në Han të Hotit për të marrë disa refugjatë të tjerë, për t`i bashkuar me familjen që gjendej në një kamp të Shkozetit. Ashtu i lodhur u nisa edhe në këtë rrugë të gjatë. Pas bashkimit të këtyre familjarëve, të cilët e kishin konsideruar të humbur njëri-tjetrin, u binda se ia ka vlejtur lodhja dhe tri net radhazi pa gjumë. Shtëpia jonë në Shkallnur ishte mbushur plot me refugjatë dhe nuk kishte as edhe një vend i lirë nëpër dhoma.

Agroni:Pas lodhjes së ditës rashë për të fjetur rreth orës 21:00. Pa zbardhur akoma drita një zë i dhimbshëm burri ma prishi gjumin, duke gjëmuar nga dhimbjet. Brofa nga shtrati dhe me sy të përgjumur dola me shpejtësi nga dhoma. Posa e hodha hapin në korridor shkela në këmbën e një njeriu. U tremba shumë nga se korridorin e kisha lënë bosh para gjumit. U kthjella dhe pash afro dhjetë persona të shtrirë. Ju afrova atij që gjëmonte nga dhimbjet në fund të korridorit. Ishte nga Cermjani i Gjakovës, e kishte njërën këmbë të këputur dhe nuk mund të flinte nga dhimbjet e mëdha. Kishin arritur pas mesit të natës. E thirra doktor Beqirin dhe pasi i dha disa ilaçe u qetësua. Nuk fjeta më atë natë nga shqetësimet për fatin popullit tim.''

## Pranë varrit të nënës, pas dhjetë vjetësh

Për vizitë po të vij
Këtu ku ke mbet
Pranë varrit më ke
S'të harroj përjetë
Tani po vij mirë
Nga Kosova e lirë
Zoti pastë mëshirë
Për shpirtin tënd të dëlirë
Kapërceva bjeshkët
Erdha në Shkallnur
Këtu ku nisen detet
Në tokë të Shqipërisë
Me t'i tregu nënë
Frytet e lirisë
Ke shkuar duke më thënë
"çka po bëhet nënë ?!''
U bë si kem pritur
U bë pavarësia
Po gëzon Kosova
Po gëzon Shqipëria
Të qoftë i lehtë dheu
I këtij fshati të mbarë
Që strehoi në kohë të luftës
Mijëra kosovarë.

*Shkallnur 7.10.2008*
*Ramadan Sheremeti*

Përballë fatkeqësive

Ata njerëz të cilët e bindin veten se reagimet e tyre ndaj streseve, vështirësive të jetës, janë të pavlefshme, dorëzohen, vihen në gjendje të pashpresë dhe në fund bien në depresion. Këtë gjendje e shkakton paaftësia për të ndihmuar veten.
Strese të shumta përjetuam edhe më përpara por disi ndryshe ishin ato që përjetuam gjatë viteve të tetëdhjeta dhe nëntëdhjeta të shekullit njëzet. Demonstratat e vitit 1981 na gjetën nëpër të gjitha strukturat e shoqërisë kosovare, nxënës, studentë, profesorë, policë etj. Ashtu sikur qeni i çartur që të del në rrugë, vazhduan pastaj diferencimet, platformat politike kundër iridentizmit, rrënimi me tanke i autonomisë së Kosovës e deri te lufta. Ishin këto kërcënime të fuqishme kundër të drejtës për jetë, liri e demokraci. Jeta në Kosovë u bë gjithnjë e më e vështirë.

Kemi qenë të edukuar që vështirësitë t`i shohim drejt në sy, pa frikë për t`u përballur me to. Kjo na ka ndihmuar që ato të na hapin rrugën. Interesat dhe dobitë personale i kemi kërkuar në interesin e përgjithshëm. Kemi fituar më pak, por jemi ndier më mirë.
Konceptin e tolerancës nuk e kemi ngatërruar me përuljen dhe servilizmin.
Pushtetit serb iu kemi kundërvënë duke i formuar institucionet paralele të Republikës së Kosovës. Mbylljes së shkollave shqipe iu kemi përgjigjur duke i hapur edhe dhomat e fjetjes për mbajtjen e mësimit. Largimit nga puna iu kemi përgjigjur me nisma dhe punë private. Plaçkitjeve që serbët i bënin në ndërmarrje private iu kemi kundërvënë me investime, atje ku nuk arrinte dora e tyre. Shkatërrimit të jetës në Kosovë dhe përndjekjes ç'njerëzore të popullit nga vatrat e tyre iu kemi përgjigjur me riorganizimin e jetës, atje ku kemi qëlluar, duke e mbrojtur, duke i dhënë dhe duke e ndihmuar njeri-tjetrin si dhe duke u përgatitur për sfidat e reja.

Goditjet më të rënda nga streset, ditën dhe natën, gjatë një viti të tërë, i përjetuam atje ku u bëmë refugjatë. Gjëja e parë që duhej të bënim për të porsaardhurit ishte të ulemi pranë tyre, t`i dëgjojmë rrëfimet tronditëse të tyre dhe të gjejmë ndonjë mënyrë për t`ua lehtësuar dhimbjet apo për t`ua mbajtur gjallë shpresat e thyera.

Nga qershori i vitit 1998 deri në qershor të vitit 1999 në Shkallnur u zhvillua një front i gjerë i luftës kundër urisë, sëmundjeve, depresionit dhe traumave. Dhe ajo luftë u fitua.

## Vlerat që kërkojnë një strehë

Këto ditë të shenjta të kombit shqiptar të shënuara me suksese të pakthyeshme siç janë: pavarësia e Kosovës, Shqipëria në NATO dhe vendimi i Gjykatës së Hagës për hedhjen poshtë të të gjitha akuzave kundër UÇK-së, klasa politike dhe intelektuale e shqiptarëve anë e mbanë botës, medoemos, e ndjeu një periudhë relaksimi nga streset e shumta e të gjata, strese këto që e kanë detyruar për përshtatje, shpeshherë edhe të dhimbshme.
Dinamizmi i zhvillimeve kombëtare, pas përballimit të eksodit të shqiptarëve të Kosovës në vitet 1998/99, të vlerësuar "me përmasa biblike" ka bërë që shumë vlera të krijuara në atë kohë dhe të rëndësishme për njerëzimin, të struken duke pritur shpalosjen e radhës. Humanizmi i popullit shqiptar si dhe ndërgjegjja e fuqive të botës, në atë kohë u vu në sprovë dhe atë sprovë e kaluan me shumë sukses. Bota i vlerësoi me notë të lartë.
Në muajin qershor, kur është edhe "dita botërore e refugjatëve" mbushen dhjetë vite nga dita kur u themelua qendra e parë e refugjatëve kosovarë në Shkallnur të Durrësit, ku gjenden regjistrat e saktë për 14 470 refugjatë, për të gjitha llojet e ndihmave që atyre u janë dhënë, strehimi, furnizimi me ushqime, me mjete higjienike, me shtroja e mbuloja, furnizimi me tekste për vazhdimin e vitit shkollor 1998/99.
Atje është organizuar shkolla argëtuese për fëmijë, rehabilitimi i personave të traumatizuar nga torturat dhe lufta. Janë organizuar trajnime nga më të ndryshmet, përfshirë edhe trajnimin "Të drejtat e njeriut nëpër shkolla" për mësimdhënësit.
Në Shkallnur është organizuar edhe mbrojtja shëndetësore duke ofruar shërbime ambulance në 12 234 raste si dhe vizita shtëpiake për ata që nuk kanë pasur mundësi të sillen në ambulancë për 1 684 raste. Në të gjitha këto janë dhënë terapitë adekuate falas.
Për të gjitha këto që u përmendën, janë gjetur donatorë vendas e të huaj, si dhe njerëz me vullnet të mirë të cilët kanë menaxhuar me kujdesin më të madh. Meqenëse ekzistojnë shënimet origjinale të evidentimit të këtyre fakteve në Shkallnur, ndoshta dokumente të tilla ekzistojnë gjithandej ku kanë qenë të strehuar refugjatë nga Kosova, në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi etj.
Vlerat e krijuara në atë kohë, me të cilat dokumentohen se çfarë kanë bërë njerëzit humanë për njerëzit fatkeq, kërkojnë dhe meritojnë të kenë një strehë. Mendoj se është detyrë e Qeverisë së Kosovës të caktojë një grup pune, i cili në bashkëpunim me qeveritë e vendeve përkatëse të grumbullojnë këto dokumente, t'i sistemojnë ato në një arkiv apo muze të posaçëm, ku mund t'i shfrytëzojnë historianët, sociologët, pedagogët, mjekët, institucionet humanitare etj. Pastaj atje ku ekzistojnë kushtet, si në Shkallnur të Durrësit, të ngrehet edhe ndonjë monument përkujtimor. Mendoj se Qeveria e Kosovës ka borxh ndaj atyre që kanë dhënë kontribute të veçanta, që së paku t'i nderojë me "Mirënjohje". Kjo do t'i bënte nder edhe popullit të Kosovës së pavarur, në këto ditët e para të afirmimit të pavarësisë.

## Letër Zonjës Kozara Kati-Tiranë

Zonjë e nderuar!
Në qershor të këtij viti do të numërohen dhjetë vite nga eksodi me përmasa biblike që i ndodhi popullit të Kosovës. Në ato ditë të paharrueshme të tragjedisë dhe të gjenocidit që përjetuan kosovarët nga forcat serbe u vu në sprovë ndërgjegjja njerëzore. Fëmijët, gratë, të moshuarit dhe të sëmurit u detyruan të arratisen nga Kosova duke lënë pas vetes familjarë të masakruar, shtëpi të djegura dhe djemtë nëpër male, duke luftuar për liri dhe pavarësi.
Shqipërisë së trazuar nga varfëria e skajshme dhe nga përplasjet politike iu shtua edhe barra e rëndë e pranimit të qindra-mijëra refugjatëve nga Kosova, barrë kjo që do të gjunjëzonte cilindo shtet.
Thuhet se aq sa bëjnë dhjetë vullnetarë nuk mund të bëjnë njëmijë të detyruar. Brenda popullit shqiptar u gjendën aq shumë vullnetarë sa që Shqipëria nuk u gjunjëzua fare. Përkundrazi ajo e forcoi kurrizin, qëndroi drejt dhe i dha mësim botës për vlerat humane të popullit shqiptar.
Familja jonë pati fatin të pranojë dhe të ndihmojë refugjatët e parë që arritën në rrethin e Durrësit dhe të ndajë me ta dhimbjet dhe shpresat, mirëpo Ju Zonjë e Nderuar, ishit vullnetarja e parë e cila nuk priti që dikush të kërkojë ndihmën Tuaj por i kërkuat dhe i gjetët ata që kanë nevojë për ndihmë. Vizita që Ju bëtë në Shkallnur me 17.6.1998 , ku ishte ngritur një Shtab nga vetë kosovarët për t'i dalë në ndihmë njeri-tjetrit, ishte shtrirje e një dore humane dhe një krah i fortë në çastin më të duhur për kosovarët. Nuk na kishte kapur mendja se në Shqipëri mund të gjendej një organizatë aq humane dhe aq e organizuar si "Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut". Çfarë bëtë Ju dhe bashkëpunëtorët Tuaj për refugjatët nga Kosova nuk mund të harrohet.
Tani, kur Kosova e fitoi pavarësinë, kur Shqipëria u ftua në aleancën atlantike dhe kur UÇK u lirua nga akuzat e ngritura kundër saj në Gjykatën e Hagës, ndihemi më të qetë dhe mund t'i shpalosim kujtimet për veprat e larta njerëzore të krijuara gjatë viteve 1998/99. Një pjesë e madhe e këtyre vlerave e ka adresën në personalitetin Tuaj, në Adrianin dhe në bashkëpunëtorët Tuaj shqiptar e joshqiptar.
Një manifestim ku do të shpalosen vlerat e krijuara në atë kohë, do t'i bënte mirë opinionit për shqiptarët në "Ditën Botërore të Refugjatëve", në kohën kur Kosova dhe Shqipëria akoma kërkojnë vendin e merituar në Evropë.
Meqenëse vlerat i njeh më mirë ai që ka vlera, është mirë që ju të merrni nismën për këtë manifestim.
Me nderime dhe respekt të veçantë për ju dhe familjen Kati, urojmë shëndet dhe gëzime!

Pejë më 12.4.2008 Familja Sheremeti nga Peja